



Treguesit Statistikorë të Tregut të Komunikimeve Elektronike 2020

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Shërbimet e komunikimeve elektronike mobile

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare _____	4
<i>Numri i përdoruesve celularë</i> _____	5
<i>Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G</i> _____	6
<i>Trafiku telefonik dhe SMS</i> _____	7
<i>Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve</i> _____	8
<i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare</i> _____	9
<i>Pjesët e tregut</i> _____	9
Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse _____	13
<i>Telefonia fikse</i> _____	13
<i>Aksesi broadband nga rrjete fikse</i> _____	16
<i>Numri i pajtimtarëve</i> _____	16
<i>Paketat e integruara (Bundles)</i> _____	18
<i>Teknologjia</i> _____	20
<i>Shpejtësia e aksesit broadband</i> _____	21
<i>Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse</i> _____	22
Të ardhurat dhe investimet _____	23

Lista e Figurave

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2015-2020	4
Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2014-2020	5
Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2013-2020	7
Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2014-2020	8
Figura 5: Terminimi i thirrjeve hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta)	9
Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2020	13
Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2020)	15
Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve	17
Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2020)	18
Figura 10: Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	18
Figura 11: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2020	21
Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë	22
Figura 13: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike nga rrjetete celulare dhe ato fikse	24
Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2020 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)	24
Figura 15: Të ardhurat totale të operatorëve celular (2011-2020)	24
Figura 16: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse	24
Figura 17: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare	26

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G	6
Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)	9
Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare	10
Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2012 - 2020	14
Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve	15
Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2012-2020	16
Tabela 7: Numri i pajtimtarëve të Albtelecom me shërbime të integruara (2013-2020)	20
Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2014-2020	23

Shërbimet e komunikimeve elektronike mobile dhe rrjeteve fikse

Bazuar në rregulloren Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar, të gjithë sipërmarrësit e autorizuar për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të rrjeteve fikse dhe mobile janë të detyruar të raportojnë në AKEP në mënyrë periodike të dhënat e tyre statistikore dhe financiare sipas afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.

Ky raport është përgatitur duke iu referuar të dhënave më të fundit të dërguara nga operatorët celularë, si dhe të dhënave të Operatorëve Alternativë dhe Ofruesve të shërbimeve. Në disa raste AKEP nuk mund të dallojë parregullsitë e raportimit të të dhënave deri në momentin kur këto të dhëna do të krahasohen në periudhat në vijim. AKEP nuk mban përgjegjësi për cilësinë e të dhënave të raportuara nga operatorët. Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen nga AKEP. Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për shkak të rumbullakimeve. Për këtë periudhë janë përdorur raportimet e 210 sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitet në ofrimin e shërbimeve të rrjeteve celulare, telefoni fikse dhe internet.

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, ka treguar më shumë se kurrë më parë, rëndësinë e shërbimeve të telekomunikacionit dhe rolin e tyre për të mbajtur aktivë dhe të lidhur shërbimet e ofruara nga Qeveritë, Bizneset dhe aktorët e tjerë të shoqërisë. Të ndikuar nga masat e marra për përballimin e pandemisë, qytetarët janë mbështetur në infrastrukturën e shërbimeve të telekomunikacionit dhe teknologjitë e avancuara për sigurimin e informacioneve, respektimin e distancimit social, si edhe kryerjen e punës nga shtëpia nëpërmjet sistemeve të telepunës.

Gjatë vitit 2020, operatorët celularë dhe ata të rrjeteve fikse kanë investuar në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për ofrimin e shërbimeve kryesisht të internetit, duke rritur shpejtësinë dhe cilësinë e qëndrueshmërisë së dërgimit të sinjalit.

Veçanërisht, gjatë periudhës së pandemisë, operatorët kanë ndërmarrë masa për rritjen e kapaciteteve të rrjetit për të mundësuar akses të qëndrueshëm të përdoruesit fundorë me shpejtësi të përmirësuar, e diktuar kjo edhe nga rritja e kërkesës konsumatore si rezultat i masave të karantinimit të ndërmarrë nga vende të ndryshme.

Nevoja për rritje dhe qëndrueshmëri të kapaciteteve ofruese të shërbimeve të telekomunikacionit ka qenë në funksion të:

- Mbajtjes së qytetarëve të informuar dhe të ndërlidhur në rrjet për të siguruar akses në shërbimet shëndetësore, financiare, tregtare, etj.;
- Ofrimit të qëndrueshëm të shërbimeve të komunikimit për bizneset;
- Lehtësimin e punës online nga shtëpia nëpërmjet aplikimit të Telepunës, etj.

Dokumenti në vijim është strukturuar në tre seksione:

- Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare;
- Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse;
- Treguesit kryesorë të të ardhurave dhe investimeve.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare

Aktualisht në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin tre sipërmarrës: Albtelecom Sh.a, One Telecommunications Sh.a dhe Vodafone Albania Sh.a. Të tre sipërmarrësit kanë raportuar të dhënat sipas afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Për shkak të karakteristikave të aksesit dhe mbulimit më të gjerë se rrjetet fikse, ofruesit e shërbimeve celulare kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në përballimin e kushteve të vështira të shkaktuar nga pandemia COVID-19 gjatë vitit 2020.

Në vijim paraqitet ecuria për disa nga treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2015-2020 dhe norma e ndryshimit vjetor në vitin 2020.

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2015-2020

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:							
– Sipas kartave SIM	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	3,378,886	3,337,824	-1.22%
– Përdorues aktivë	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	2,630,076	2,618,880	-0.43%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:							
– Totali	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	2,462,057	2,469,850	0.32%
– Përdorues aktivë	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	1,789,158	1,998,579	11.71%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	5,494,296,034	5,286,361,927	-3.78%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	2,318,816,619	2,306,339,577	-0.54%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	420,253,147	300,227,063	168,753,020	164,608,604	213,311,650	187,708,510	-12.00%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	967,833,263	660,604,925	-31.74%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	69,135,490	88,950,833	28.66%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Treguesit që kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2020:

- volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, volum i cili është rritur me rreth 28.6% krahasuar me vitin 2019.
- numri i përdoruesve aktivë të internetit rreth 11.7% më shumë.

Gjatë vitit 2020, rritjen më të madhe të volumit të të dhënave 'Data' e ka pasur Vodafone Albania me rreth 40%, e ndjekur nga One Telecommunications me rreth 21%, ndërkohë Albtelecom është përafërsisht në të njëjtat nivele si viti 2019.

Treguesit e tjerë kryesor ashtu si edhe vitet pararendëse, edhe për vitin 2020 kanë shënuar rënie krahasuar me vitin 2019, por kjo rënie ka qenë më e lehtë për sa i përket numrit të pajtimtarëve:

- numrin e pajtimtarëve sipas kartave SIM (rreth 1.22% më pak);
- numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare (rreth 0.43% më pak);

Ndërkohë, volumi i thirrjeve tradicionale voice dhe volumi i SMS-ve kanë pasur rënie më të theksuar, konkretisht:

- volumin e thirrjeve dalëse celulare me rreth 3.78%;
- numrin i SMS të dërguara nga përdoruesit me rreth 31.74%;
- volumin i thirrjeve hyrëse kombëtare të cilat janë ulur me rreth 0.54%.
- volumi i trafikut të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare me rreth 12%.


Për sa i përket rënies së numrit të SMS-ve dhe minutave të komunikimit Voice, kjo ka ardhur edhe si rezultat i përdorimit në masë të aplikacioneve OTT (Whatsapp, Viber, Messenger, Skype etj.)

nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe ‘video calls’. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe si rezultat i përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga rrjetet 4G dhe 4G+ të cilat mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve (video dhe audio) nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

Numri i përdoruesve celularë

Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas viteve vërehet se numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare ka shënuar rritje nga viti 2014 deri në fund të vitit 2017, për t’u ndjekur nga një rënie e theksuar të këtyre treguesve nga tremujori i parë 2018 e në vijim deri në fundin e tremujorit të dytë 2020.

Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2014-2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Bazuar në grafikun sa më sipër, vërehet se që nga viti 2018 e në vijim numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare për periudhat tremujore ka pasur luhajtje të vogla, krahasuar me rënien e theksuar gjatë vitit 2017 (arsyet për të cilat janë paraqitur në raportet vjetore 2018-2019).

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 vërehet një rënie e treguesve kryesor krahasuar me periudhën e mëparshme T1 2020 apo edhe me T2 2019. Në përgjithësi të tre operatorët referojnë si arsye kryesore efektet e pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, që kanë sjellë:

- Reduktim të konsumit të njësive të paketave bundle gjatë mbylljes (lockdown) nga data 1 Mars 2020 deri në fillim të muajit Qershor;
- Reduktim të numrit/pagesave të paketave standarde të riaktivizuara;
- Uljen e numrit të turistëve dhe emigrantëve për shkak të vështirësive të transportit ndërkombëtar;

- Rritje të përdorimit të broadband fiks (WIFI) duke zëvendësuar në këtë mënyrë përdorimin e internetit nga shërbimet celulare.

Bazuar nga informacionet e marra nga operatorët edhe nga analizat e kryera nga AKEP për këtë çështje, rezulton se pandemia e shkaktuar nga Covid-19 përgjatë këtij 3 mujori, ka pasur efekte të ndjeshme në drejtim të rënies së treguesve kryesorë të shërbimeve celulare duke përfshirë edhe ato broadband, disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë rënie janë:

- Mos-aktivizimit të paketave në mënyrë periodike për numrat me parapagesë;
- Mungesën e marketingut ne terren;
- Mos-shpërndarjen e kartave të reja;
- Kufizimit në pagesa në pikat e shitjes dhe oraret e reduktuara te ofrimit te shërbimit;
- Kufizimit të shërbimeve sezonale nga emigrantët dhe turistët dhe shërbimeve roaming të abonentëve jashtë Shqipërisë;
- Zhvendosje të përdorimit të internetit nga rrjetet fikse si rezultat i përdorimit të shërbimit WIFI (i ofruar nga rrjetet fikse) gjatë qëndrimit në shtëpi të pajtimtarëve.

Ndërkohë që gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, si rezultat i lehtësimit të masave për përballimin e situatës së pandemisë, vërehet rritje e të gjithë treguesve kryesor.

Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G

Siç është përmendur edhe më sipër, ofrimi i shërbimit të internetit ka qenë një ndër shtyllat kryesore që ka ndikuar pozitivisht në përballimin e vështirësive të krijuara nga situata e pandemisë gjatë vitit 2020. Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në internet gjatë vitit 2020 paraqitet si vijon:

- rreth 2.4 milion përdorues që e kanë përdorur rrjetin të paktën një herë gjatë vitit 2020;
- rreth 1.9 milion përdorues aktivë (përdorim të internetit në tre muajt e fundit).

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G

	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communications	Total	Norma e pentrimit për popullsi
2011	55,000	228,249	-	-	283,249	10%
2012	240,715	408,998	-	-	649,713	23%
2013	311,566	634,293	285,400	-	1,231,259	43%
2014	225,346	550,196	132,433	-	907,975	32%
2015	375,973	706,880	214,428	-	1,297,281	46%
2016	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
2017	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%
2018	605,984	931,730	272,282		1,809,996	63%
2019	567,572	940,949	280,737		1,789,258	63%
2020	718,631	981,483	298,465		1,998,579	70%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparateve celulare, ku në fund të vitit 2020 kjo shifër arriti në 70%, krahasuar me 63% në fund të vitit 2019.

Ndërsa numri i përdoruesve aktivë nëpërmjet kartave USB/modem për vitin 2020 arriti në rreth 110 mijë përdorues duke shënuar një rënie me rreth 13% në krahasim me vitin 2019. Rënia e përdorimit të internetit nëpërmjet kartave USB/modem ndikohet nga rritja e ofrimit të shërbimit të internetit nëpërmjet pajisjeve celulare, si edhe rritja mjaft e madhe e ofrimit të shërbimit broadband nga rrjetet fikse.

Trafiku telefonik dhe SMS

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2020 ishte rreth 5.3 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 3.78% në krahasim me vitin 2019 (5.5 miliard minuta).

Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2013-2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Edhe gjatë vitit 2020, volumi i thirrjeve kombëtare drejt rrjeteve celulare (on-net dhe off-net) ka shënuar rënie, krahasuar me vitin 2019:

- sasia e thirrjeve on-net u reduktua me 5%,
- thirrjet off-net u reduktuan me 2%.

Trendet e ndryshme të nivelit të thirrjeve sipas destinacionit të paraqitura në tabelën sa më sipër, kanë rezultuar në ndryshime të mëtejshme në strukturën e trafikut dhe në përafrim të ndjeshëm të sasive të trafikut on-net dhe off-net, sikurse paraqitet në figurën e mëposhtme.

Numri i SMS-ve të dërguara gjatë vitit 2020 ishte rreth 660 milion ose rreth 31.74% më pak se në vitin e kaluar.

Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2014-2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare dhe reduktimet në thirrjet on-net në periudhën 2015-2020 kanë ndodhur si rrjedhojë e zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, që filluan të zbatohen në korrik 2015.


Vërehet se gjatë viteve 2019-2020 pesha e thirrjeve on-net dhe off-net është stabilizuar në kufijtë përkatësisht rreth 42% off-net dhe rreth 56% on-net.

Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse (nga rrjetet e tjera) të terminuara në rrjetet celulare në vitin 2020 ishte rreth 2.49 miliard minuta, që përbën rënie me 2% në krahasim me vitin paraardhës. Terminimi i thirrjeve kombëtare u ul me 1.15% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe pësoi një rënie të lehtë prej 0.53% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare.

Siç mund të vihet re trendi rritës i përdorimit të Data-ve është në kah të kundërt me trendin e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve, duke evidentuar efektin zëvendësues të këtyre shërbimeve tradicionale me shërbimet e ofruara nga aplikacionet OTT që mundësohen nga aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G.

Figura 5: Terminimi i thirrjeve hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Bazuar në të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve mobile, vërehet se volumi i përdorimit mesatar mujor për përdorues aktivë ka shënuar rënie me rreth 2% për treguesit e thirrjeve, ndërkohë trafiku mesatar i përdorimit të internetit është rritur me rreth 15% krahasuar me vitin 2019.

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019
Thirrje dalëse	152	156	172	182	166	155	158	171	168	-2%
Thirrje të marra	168	167	168	171	169	156	161	177	174	-2%
MOU	319	324	341	353	335	311	319	348	341	-2%
SMS Dalese	35	39	43	39	39	33	31	30	30	0%
Trafik Data (GB)	N/A	0.22	0.48	0.96	1.49	2.06	2.6	3.4	3.9	15%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2020, një përdorues celular aktiv ka kryer mesatarisht 168 minuta thirrje dalëse në muaj, ka dërguar 30 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 3.9 GB në internet broadband.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në mesataren e thirrjeve/SMS janë reduktimi i bazës së përdoruesve aktivë të shërbimeve mobile, si edhe rritja e përdorimit të shërbimeve të komunikimit (sms, voice, video) nëpërmjet aplikacioneve OTT.

Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM.

Pjesët e tregut

Deri në vitin 2017 në tregun e ofrimit të shërbimeve elektronike celulare kanë operuar katër operatorë dhe që nga 1 Janari 2018 me daljen e Plus Communications nga tregu ushtrojnë aktivitetin tre operatorë. Edhe pas daljes së Plus nga tregu, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të qenësishëm strukturor për sa i përket pjesëve të tregut, ku operatorët kanë ruajtura pothuajse të njëjtën peshë në treg. Tabela në vijim paraqet pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë të shërbimeve celulare.

Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare

		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2011	37%	35%	21%	8%	3,052
	2012	33%	36%	25%	5%	3,085
	2013	39%	43%	13%	6%	3,525
	2014	40%	40%	14%	7%	3,399
	2015	34%	42%	16%	8%	3,222
	2016	32%	49%	14%	4%	3,691
	2017	32%	49%	14%	5%	3,676
	2018	34%	50%	15%	0%	3,954
	2019	33%	50%	17%	0%	3,883
	2020	37%	47%	16%	0%	3,833
		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2011	34%	48%	13%	6%	3,620
	2012	40%	42%	12%	6%	3,549
	2013	38%	45%	12%	6%	3,600
	2014	34%	46%	13%	8%	3,460
	2015	33%	47%	14%	6%	3,499
	2016	31%	51%	13%	5%	3,724
	2017	34%	48%	13%	6%	3,620
	2018	37%	47%	16%	0%	3,842
	2019	36%	48%	16%	0%	3,849
	2020	37%	47%	16%	0%	3,829
		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues aktivë	2011	19%	81%	N/A	N/A	6,871
	2012	37%	63%	N/A	N/A	5,335

broadband (3G/4G)	2013	25%	52%	23%	N/A	3,831
	2014	25%	61%	15%	N/A	4,501
	2015	29%	55%	17%	N/A	4,082
	2016	27%	55%	14%	4%	3,944
	2017	30%	51%	14%	5%	3,708
	2018	37%	47%	16%	0%	3,842
	2019	32%	53%	16%	0%	4,018
	2020	36%	49%	15%	0%	3,928
One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI						
Thirrje dalëse	2011	37%	51%	10%	2%	4,074
	2012	39%	50%	8%	3%	4,094
	2013	39%	51%	7%	3%	4,180
	2014	34%	50%	11%	5%	3,797
	2015	32%	49%	13%	6%	3,642
	2016	34%	52%	11%	4%	3,940
	2017	34%	48%	11%	7%	3,646
	2018	35%	52%	13%	0%	4,093
	2019	34%	53%	13%	0%	4,112
	2020	34%	53%	13%	0%	4,166
One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI						
SMS dalëse	2011	27%	64%	8%	1%	4,890
	2012	20%	73%	6%	1%	5,766
	2013	21%	73%	5%	1%	5,796
	2014	19%	66%	5%	10%	4,898
	2015	18%	66%	8%	8%	4,787
	2016	21%	67%	9%	3%	4,988
	2017	25%	60%	10%	5%	4,325
	2018	27%	61%	12%	0%	4,602
	2019	26%	60%	14%	0%	4,483
	2020	26%	60%	14%	0%	4,464
One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI						
Trafiku të dhëna (Gbyte)	2011	23%	43%	26%	8%	3,099
	2012	27%	54%	14%	5%	3,857
	2013	21%	57%	17%	4%	4,063
	2014	16%	49%	30%	4%	3,632
	2015	18%	51%	29%	3%	3,727

	2016	21%	55%	22%	2%	3,937
	2017	24%	55%	18%	2%	3,970
	2018	26%	55%	19%	0%	4,086
	2019	24%	59%	16%	0%	4,113
	2020	23%	64%	13%	0%	4,675
	One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI					
Të ardhura totale nga komunikimet	2011	34%	52%	12%	2%	3,987
	2012	29%	56%	10%	4%	4,120
	2013	33%	50%	11%	6%	3,744
	2014	34%	48%	12%	6%	3,665
	2015	34%	47%	12%	7%	3,582
	2016	31%	49%	12%	9%	3,522
	2017	30%	49%	12%	8%	3,549
	2018	32%	54%	14%	0%	4,137
	2019	31%	54%	14%	0%	4,149
	2020	34%	53%	13%	0%	4,129
	One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI					
Të ardhura retail	2011	36%	49%	13%	2%	3,882
	2012	33%	50%	12%	5%	3,751
	2013	32%	52%	11%	6%	3,815
	2014	30%	53%	11%	5%	3,926
	2015	28%	54%	12%	5%	3,894
	2016	28%	56%	12%	5%	4,052
	2017	31%	51%	13%	5%	3,746
	2018	32%	55%	14%	0%	4,173
	2019	31%	55%	14%	0%	4,156
	2020	33%	54%	14%	0%	4,139

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

1. Sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile duke shënuar rënie të lehtë për pjesën më të madhe të këtyre treguesve krahasuar me vitin 2019, konkretisht pjesët e tregut për vitin 2020 variojnë me:

- mbi 47% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card;
- mbi 47% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë;
- mbi 60% të tregut për volumin e të dhënave (internetit) dhe SMS-ve;
- mbi 49% të tregut për trafikun e minutave dhe përdoruesve aktivë të internetit;
- 53% të tregut për të ardhurat totale;

- 54% të ardhurat nga shërbimet me pakicë.
2. Ndjekësi më i afërt është sipërmarrësi One telecommunications, që ka shënuar rritje të lehtë të pjesës dërmuese të treguesve kryesorë me rreth 1-4 (pp), pjesët e tregut për vitin 2020 variojnë si vijon:
 - 23-37% pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband;
 - 34% të tregut për të ardhurat totale;
 - 33% të ardhurat nga shërbimet me pakicë.
 3. Sipërmarrësi me pjesën më të vogël të tregut është Albtelecom i cili ka shënuar rënie të lehtë (rreth 1 pp) të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2019, rënie ka shënuar për treguesin e trafikut të të dhënave nëpërmjet internetit (Data) me rreth 3 (pp). Pjesët e tregut për vitin 2020 variojnë:
 - 13-16% % pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband;
 - 13% të tregut për të ardhurat totale;
 - 14% të ardhurat nga shërbimet me pakicë.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse

Telefonia fikse

Në fund të vitit 2020 numri i sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse në Shqipëri është 260, nga të cilët 256 ofrojnë shërbime të internetit nga rrjetet fikse dhe 57 operatorë janë pajisur me numeracion gjeografik. Pjesa më e madhe e operatoreve alternative janë te vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.


Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP rezulton se numri i operatorëve të autorizuar të rrjeteve të telefonisë fikse që kanë raportuar se kanë pasur aktivitet gjatë 2020 në telefoninë fikse është rreth 40 dhe 183 operatorë kanë ofruar shërbimet broadband fikse.

Ofrimi i shërbimeve të telefonisë fikse për kryerjen e thirrjeve voice gjithnjë e më shumë e ka ulur pjesën e saj në treg, kjo edhe si rezultat i lehtësisë dhe rritjes së vazhdueshme të shërbimeve nga rrjetet celulare. Shërbimi i telefonisë fikse ofrohet kryesisht si pjesë e paketave të shërbimeve të rrjeteve fikse të kombinuara (internet, IPTV, telefoni fikse dhe së fundmi edhe mobile), trendi rënës për këtë tregues evidentohet në të gjitha ekonomitë e botës.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në Shqipëri në vitin 2020 ka pësuar një rënie rreth 8%, konkretisht nga 243 mijë në fund të vitit 2019 në 223 mijë në fund të vitit 2020.

Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2020 arriti në 7.9%, duke pësuar një rënie krahasuar me vitin 2019 kur ky tregues ishte 8.46%.

Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2012 - 2020

	Albtelcom	Abcom	ASC	1Abissnet[1]	Nisatel	OA te tjere	Total
2012	230,397	33,000	7,649	N/A	5,500	35,115	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	N/A	7,166	34,925	281,200
2014	182,591	15,531	14,010	N/A	9,423	24,202	245,757
2015	180,735	12,316	30,670	N/A	4,828	24,190	252,739
2016	176,733	13,946	37,765	3,823	4,306	15,890	248,640
2017	171,516	15,282	42,829	3,982	2,470	14,623	246,720
2018	177,129	11,637	40,377	4,049	4,100	11,339	248,631
2019	176,653	11,409	35,558	4,095	4,098	11,046	242,859
2020	168,142	8,524	30,399	4,154	4,122	8,128	223,469
Ndryshimi 2020/2019	-5%	-25%	-15%	1%	1%	-26%	-8%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, operatori me pjesën më të madhe në treg është Albtelcom rreth 75%, i ndjekur nga ASC me rreth 14%, ABCom dhe OA të tjerë me nga 4% dhe Nisatel dhe Abissnet me nga 2%. Ajo që konstatohet është se pjesa e pajtimtarëve për të gjithë operatorët kryesor ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2019, ndërkohë që Abissnet dhe Nisatel ka pasur rritje me rreth 1%.

1 Për Abissnet te dhënat janë paraqitur që nga viti 2016

Në figurën në vijim paraqitet norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas Qarqeve në nivel urban dhe rural.

Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2020)

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 52% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun e Tiranës. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe.



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelecom në vitin 2020 u reduktua me 8% në krahasim me vitin 2019, ndërsa mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks të Albtelecom është reduktuar nga 35 minuta në vitin 2019 në 33 minuta në vitin 2020.

Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve

	Total	Albtelecom	Abcom	ASC	OA të tjerë
	223,469	168,142	8,524	30399	16,404
Berat	8,408	7,895	173	3	337
Dibër	3,156	3,154	0	0	2
Durrës	20,079	13,955	457	5177	490
Elbasan	8,068	7,220	497	190	161
Gjirokastrë	8,005	6,996	0	4	1,005
Fier	8,361	6,547	424	746	644
Korçë	15,472	13,743	670	21	1,038
Kukës	2,807	2,796	0	5	6
Lezhë	8,286	5,728	0	2,535	23
Shkodër	8,937	6,465	820	3	1,649
Tiranë	115,851	83,349	4,709	20,994	6,799
Vlorë	16,039	10,294	774	721	4,250

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Albtelecom është operatori i vetëm me shtrirje të rrjetit në të gjitha Qarqet e vendit, si edhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kombëtare për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse. Operatorët e tjerë, janë të përqendruar në qarqet më të mëdha të vendit, kryesisht zonat me densitet të lartë të popullsisë.

Aksesi broadband nga rrjete fikse

Numri i pajtimtarëve

Të afektuar edhe nga situata e pandemisë e shkaktuar nga COVID-19, gjatë vitit 2020 zhvillimi i ofrimit të shërbimit të internetit nga rrjetet fikse ka pasur një rritje të konsiderueshme në Shqipëri si për sa i përket numrit të pajtimtarëve të rinj, ashtu edhe rritjes së niveleve të shpejtësisë për ofrimin e këtij shërbimi.

Për herë të parë, numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2020 tejkaloi shifrën e 508² mijë pajtimtarëve, duke u rritur me rreth 17% në krahasim me vitin 2019 dhe pothuajse dyfishuar krahasuar me vitin 2016.

Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2012-2020

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	Nisatel	Digicom	OA të tjerë	Total
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	N/A	N/A	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	N/A	N/A	29,890	182,556
2014	82,747	47,480	23,259	28,489	N/A	N/A	25,956	207,931
2015	97,597	51,093	24,497	31,357	N/A	N/A	38,326	242,870
2016	109,851	52,442	29,497	37,650	7,421	N/A	36,939	266,379
2017	120,204	55,860	28,633	46,118	7,500	6,378	38,919	303,612
2018	129,329	64,020	37,055	49,359	13,473	14,322	54,389	361,947
2019	133,515	74,708	40,849	52,773	13,809	18,516	102,022	436,192
2020	128,877	95,558	41,576	58,529	17,609	22,400	144,388	508,937
Ndryshimi 2020/2019	-3%	28%	2%	11%	28%	21%	42%	17%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tabela më sipër paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2012-2020 për operatorët kryesorë në treg, ku ka pasur një ndryshim të pjesëve të tregut për operatorët kryesorë.

Për vitin 2020 operatorët me pjesët më të madhe të tregut fiks janë renditur si më poshtë:

- Albtelecom zotëron rreth 25% pjesë tregu;
- Abcom zotëron 19% pjesë tregu;
- ASC zotëron 12% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 8% pjesë tregu;


² Të dhënat janë përditësuar me raportimet e përpunuara deri në fillim të muajit Maj 2021

- Rritje të ndjeshme gjatë viteve 2018 – 2020 ka shënuar kategoria OA (operatorë) të tjerë, e cila përbën 28% të tregut gjatë vitit 2020, duke arritur në më shumë se 144 mijë pajtimtarë.
- Digicom zotëron rreth 4% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron 3% pjesë tregu.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi dhe për numër familjesh gjatë periudhës 2011-2020. Në vitin 2020 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte rreth 70% për familje dhe 17.8% për popullsi.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi gjatë periudhës 2011-2020.

Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve³




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Bazuar në të dhënat rajonale në 2020 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 40.18% dhe 27.8% ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 22%, i ndjekur nga Tirana dhe Shkodra me nga 10% dhe 9%.

³ Të dhënat e popullsisë dhe familjeve sipas Census 2011

Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një normë relativisht të ulët të penetrimit të internetit nëpërmjet rrjeteve fikse në zonat urbane mesatarisht 28% dhe në zonat rurale mesatarisht 7%.

Paketat e integruara (Bundles)


Të dhënat e trajtuara më sipër tregojnë se shërbimi telefonik prej disa vitesh rezultojnë të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse. Nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve tashmë janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara (duo, triple dhe quad play).

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara (bundles) të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezultojnë të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2020 arriti në rreth 294 mijë, rreth 10% më shumë se në vitin 2019.

Në vitin 2020 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 58% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 35% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Figura 10: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), ka rënie rreth 6% krahasuar me vitin 2019.

Tregu i ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish dhe si rezultat në këtë treg konkurrueshmëria është e lartë. Vetëm disa nga subjektet pjesë e këtij tregu kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit, pjesa tjetër konkurrojnë në segmente më të vogla kryesisht janë ofrues lokalë.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën e mësipërme, vërehet se përdorimi i shërbimeve të integruara (Telefoni, Internet dhe TV) rezulton të jetë më i përdoruri ndër tre klasifikimet dhe është shoqëruar me një rënie gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin 2019 (rreth 6 pp), sikundër rritje të konsiderueshme ka pasur përdorimi i shërbimeve të integruara (Internet dhe TV) i cili arriti në rreth 101 mijë gjatë vitit 2020 ose 42% rritje në krahasim me vitin 2019. Ndërkohë që pjesa e tregut për shërbimet e integruara (Telefoni fikse dhe internet) është në të njëjtin nivel sa viti 2019 (rreth 31%).

Tabela 7: Numri i pajtimtarëve të Albtelecom me shërbime të integruara (2013-2020)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	109,851	120,204	129,329	133,515	128,877	-3%
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	109,034	118,050	126,695	130,685	125,873	-4%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	33,673	37,783	42,503	46,609	48,811	5%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	75,361	80,264	84,191	84,056	76,928	-8%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Tabela e mësipërme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2020. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Albtelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2020 rreth 60% e pajtimtarëve me akses broadband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV). Gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet nëse përdorin shërbime të kombinuara.

Teknologjia

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është FTTH/FTTB e ndjekur nga lidhjet DSL duke shënuar rritje me rreth 68% krahasuar me vitin 2019. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 33% të totalit të lidhjeve broadband fiks dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.

Lidhjet me fibër optike në Shqipëri (FTTH/B) për vitin 2020 përbëjnë 46% të totalit të lidhjeve dhe kanë një rritje prej rreth 14 pp krahasuar me vitin 2019. Ofrimi i shërbimit të internetit nëpërmjet fibrës optike ofron marrjen e shërbimit me cilësi dhe qëndrueshmëri më të lartë.

Figura 11: Lidhjet broadband fikse sipas teknologjisë Shqipëri 2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Shpejtësia e aksesit broadband

Rritja e numrit të pajtimtarëve të shërbimeve internet, si edhe zhvillimet teknologjike paralelisht sjellin edhe rritjen e kërkesës së cilësisë në ofrimin e këtyre shërbimeve. Përdoruesit e internetit, si shkak edhe i tendencave dhe nevojës për të kryer punë online, ku gjithnjë e më shumë punonjësit e kompanive të ndryshme, ndikuar edhe nga pandemia, ka diktuar rritjen e kërkesës për të pasur lidhje me shpejtësi dhe qëndrueshmëri më të lartë, si edhe nevojën për mbulimin edhe të zonave rurale të pambuluara, kryesisht atyre me potencial për ofrimin e shërbimeve të turizmit.

Figura e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura përgjatë viteve 2015-2020. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur nga pajtimtarët është 10-30 Mbps me 43% në vitin 2020.

Në vitin 2020 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 30-100 Mbps me rreth 4-fishim të pajtimtarëve.

Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Nga sa më sipër, vërehet se pajtimtarët po zhvendosen gjithnjë e më shumë nga paketat e ofruara me shpejtësi të ulët drejt atyre që ofrojnë shpejtësi dhe cilësi më të lartë. Konkretisht, gjatë vitit 2020, pjesa e pajtimtarëve që përdorin shpejtësi më shumë se 10 Mbps ka arritur në 67%, krahasuar me rreth 41% që ishte në vitin 2019.

Zhvendosja e pajtimtarëve drejt paketae që ofrojnë shpejtësi interneti më të lartë dhe teknologji rrjeti bashkëkohore ju mundëson atyre të marrin shërbimet e kërkuara me cilësi më të lartë dhe pa ndërprerje.

Për sa i përket rritjes së niveleve të shpejtësisë së ofruar vlen të theksohet, se gjatë vitit 2020 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e pajtimtarëve që përdorin rrjet me shpejtësi më të madhe se 100 Mbps, ku nga rreth 6,500 në vitin 2019, ky numër ka arritur në 15,400 në vitin 2020.

Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse

Përdorimi i infrastrukturës në tërësinë e saj është e ndërvarësuar jo pak nga fakti në se kjo infrastrukturë është nën administrimin dhe në funksion të ofruesve të rrjeteve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, apo është edhe pjesë infrastrukturore e utiliteteve të tjera si OSHEE, Ujësjellës, Autoritete Rrugore etj. (ofrues infrastrukturë në territorin e Shqipërisë).

Aspekti i përdorimit të infrastrukturës në tërësinë e tij, konsideron të dy versionet e infrastrukturës aktive dhe pasive duke konsideruar edhe përfshirjen e infrastrukturave mbështetëse nga utilitete të tjera të cilat mund të vihen në dispozicion për zhvillimin e mëtejshëm të rrjeteve/shërbimeve të komunikimit elektronik. Këtij synimi i shërben edhe Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, me arsyetimin për të evituar kosto të pakthyeshme të investimeve në ndërtimin e infrastrukturës specifike të komunikimit elektronik. Kjo mundësi direkt impakton pozitivisht edhe përdoruesin fundor në përfitimin e më shumë produkte/shërbimeve të komunikimeve elektronike, sa më afër

pozicionit gjeografik ku ndodhet ai, me maksimumin e mundshëm të përfitimeve si tarifa por edhe në karakteristikat funksionale të produktit/shërbimit përkatës.

Në këtë këndvështrim, ekziston mundësia e aksesit në infrastrukturë fizike nga dy kategori ofruesish të infrastrukturës, nga ofrues të sektorit të komunikimeve elektronike, por edhe nga ofrues të rrjeteve dhe utiliteteve të tjera si: infrastrukturë rrugore, e energjisë elektrike, ujësjellësit, etj.

Në infrastrukturën aktive të shërbimeve të internetit nga rrjetet fikse me pakicë numri i bizneseve është 4,693 ndërkohë që numri i linjave të dhëna me qira është 3,637 me kapacitet total rreth 145 mijë Mbit/s. Ndërsa numri i i operatorëve që ofrojnë akses me shumicë është 66 me 1,432 linja që arrijnë kapacitetin 194 mijë Mbit/s.

Për sa i përket infrastrukturës pasive kontribuesi kryesor ka qenë Albtelecom, i cili ka rritur aksesin në vitin 2020 me 1,473 km dark fibër dhe 72 km tubacione. Sipërmarrësit e tjerë që kanë rritur aksesin në dhënie me qira të fibrës optike të pandriçuar (dark fibër) janë: Albanian Telecommunications Union me 205 km, ASC me 136 km, Abcom me 125 km etj. Ndërsa për sa i përket aksesit në tubacione sipërmarrësit e tjerë që kanë ofruar akses janë: Vivo Communications me 1 km dhe Abissnet me 2 km.

Albtelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Për vitin 2020, 71% e fibrës optike dhe 95% e aksesit në tubacione janë ofruar nga Albtelecom.

Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2014-2020

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019
Ofrim akses në infrastrukturë aktive								
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	345	508	532	651	1,466	2,295	1,432	-38%
Kombëtare	328	489	508	633	1,445	2,265	1,404	-38%
Ndërkombëtare	17	19	24	18	21	30	28	-7%
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)	34,793	36,826	44,423	111,311	176,496	208,661	194,143	-7%
Kombëtare	33,392	35,346	36,464	107,383	174,616	206,148	191,713	-7%
Ndërkombëtare	1,401	1,480	7,959	3,928	1,880	2,513	2,430	-3%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)								
Dark fiber	927	924	1,529	1,397	1,809	1,891	2,084	10%
Akses në tubacione	19	61	74	72	75	78	76	-2%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Treguesit kryesorë të të ardhurave dhe investimeve


Të ardhurat dhe investimet

Efektet e shkaktuara nga situata pandemike janë ndjerë edhe në rezultatet financiare të operatorëve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, përgjatë vitit 2020 ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike raportuan rreth 33.4 miliard lekë të ardhura nga komunikimet elektronike, ose 6% më pak krahasuar me vitin 2019.

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë ato të gjeneruara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet të telefonisë celulare, konkretisht rreth 23.8 miliardë lekë, me një rënie me rreth 9% nga viti 2019.


Për sa i përket të ardhurave nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse, të ardhurat e raportuara janë rreth 9.5 miliardë lekë, shifër kjo rreth 4% më e lartë se ajo e vitit të kaluar.

Figura 13 :Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike nga rrjetete celulare dhe ato fikse⁴



Në grafikun në vijim paraqiten të ardhurat nga shërbimet e komunikimeve elektronike për vitin 2020 sipas operatorëve kryesorë.

Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2020 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Nga të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, evidentohet se:

- operatori me peshën më të madhe të të ardhurave në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike është Vodafone Albania me rreth 38% të totalit të të ardhurave;
- ndjekur nga One Telecommunications me rreth 24%;

⁴ Të ardhurat nga rrjetet fikse për vitet 2018, 2019 janë përditësuar sipas raportimeve të operatorëve

- në vendin e tretë sipërmarrësi Albtelcom me rreth 21% të tregut për të dy rrjetet fikse dhe mobile;
- pjesa tjetër rreth 17% u takon operatorëve të tjerë të rrjeteve fikse.

Figura 13: Të ardhurat totale të operatorëve celular 2011-2020 (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Gjatë vitit 2020 të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve mobile paraqiten me një rënie prej rreth 9% nga viti i kaluar, rënien më të madhe e ka shënuar Albtelcom prej rreth 16%, Vodafone Albania me 11%, ndërsa One telecommunicationme ka rënie me vetëm 2%.

Për sa i përket treguesve të rezultatatit financiar neto vjetor One Telecommunications është shfaqur me rezultuat neto pozitiv rreth 820 milionë lekë. Rezultat pozitiv ka raportuar edhe Vodafone Albania me rreth 120 milionë lekë, që shënon një rënie të ndjeshme nga fitimi i realizuar vitin e kaluar. Në ndryshim nga dy sipërmarrësit e tjerë, Albtelcom gjatë vitit 2020 ka raportuar rezultat financiar negativ me rreth 1 miliardë e 175 milionë lekë, duke e thelluar humbjen nga rreth 654 milionë lekë humbje që raportonte për vitin 2019.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbimet e komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse për vitin 2020 rezulton se në këtë treg janë realizuar rreth 9,571 milionë lekë të ardhura, shifër kjo rreth 4% më e lartë se të ardhurat e raportuara për vitin 2019.


Në grafikun në vijim, paraqitet shpërndarja e të ardhurave sipas operatorëve kryesorë.

Figura nr 16: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë (milionë lek)



Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër vërehet se Albtelecom është sipërmarrësi me pjesën më të madhe të të ardhurave të këtij tregu rreth 41%, i ndjekur nga operatorët e tjerë me rreth 23%, Abcom me rreth 17% të tregut, ASC me rreth 7% , Abissnet dhe Digicom me rreth 4%.

Figura 17: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet në grafikun më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë kanë pësuar rënie të theksuar gjatë tre viteve të fundit, duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2011, ndërkohë që të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet me pakicë gjatë periudhës 2017-2019 kanë pësuar rritje të lehtë, për tu ndjekur nga një rënie e lehte në periudhën 2019-2020.

Gjatë vitit 2020 investimet totale të raportuara në infrastrukturën e rrjetit celular arritën vlerën 6.8 miliardë lekë, që tregon një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme, konkretisht:

- One Telecommunications ka investuar në total rreth 4.3 miliardë lekë,
- ndjekur nga Vodafone Albania me rreth 2.2 miliardë lekë
- Altelecom ka investuar në total rreth 436 milionë lekë.

Ecuria e investimeve në rrjetet celulare tregon se në dy vitet 2016-2017 ka pasur një rënie të ndjeshme të investimeve, e ndikuar edhe nga diz-investimet e Plus (shitja e asetëve), për tu ndjekur nga një rritje gjatë viteve të fundit.

Rritja e investimeve në rrjetin e shërbimeve celulare do ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimeve të konsumatorëve fundorë.

Domosdoshmëria për investime gjithnjë e më të mëdha nga ana e sipërmarrësve afektohet në dy drejtime:

- nga njëra anë kërkesa konsumatore gjithnjë e në rritje për shërbime sa më cilësore, për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve standarde dhe nivele si ato në vendet e tjera më të zhvilluara,
- nga ana tjetër është presioni i nivelit të ulët të të ardhurave dhe fitimeve të sipërmarrësve gjë e cila ndikon drejtpërdrejtë në aftësitë e tyre për të investuar në rrjete me cilësi më të lartë shërbimi siç janë rrjetet 4G dhe ato 5G.

Bazuar në raportimet e kryera sipërmarrësit e rrjeteve fikse përgjatë vitit 2020 kanë kryer më shumë se 2,765 milionë lekë investime të cilat kryesisht kanë si destinacion përmirësimin e aksesit të shërbimeve broadband.